- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlere absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomike më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti kontraktor përllogarit çmimin bazuar në:

- a) *çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date;*
- b) *elementet fiskale;*
- c) *normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;*

Shtojca 3.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

Nr	Përshkrimi	Sasia	Cmimi per njesi	Vlera Totale
1	FV. Njësia e delegatëve – mikrofon tavoline digjital	19		
2	FV. Njësia e kryetarit– mikrofon tavoline me prioritet	1		
3	FV. Njësia qendrore e kontrollit për sistem konference digjitale	1		
4	FV. Altoparlantë mural, min 60W / sistem 100V	4		
5	FV. Amplifikatori audio profesional, sistem 100V, min. 250W	1		
6	FV. Mikrofon wireless set marres+mikrofon dore	2		
7	FV. Rack metalik për pajisje, 600 × 600 mm, 22U	1		
8	FV. Kabëlli zgjatues me konektor 6 pole, mashkull-femer, 20m	2		
9	FV. Kabëlli zgjatues me konektor 6 pole, mashkull-femer, 5m	6		

10	FV. Kanaline plastike për kabllim, 40 × 25 mm, ml	65		
11	FV. Kabell audio per lidhjen e bokseve 2x1.5mm	75		
			Totale ALL	
			Tvsh 20%	
			Vlera Tot me tvsh ALL	

1	2	3	4	5	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	cmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike të përgjithshme:

Specifikime teknike të sistemit konferencë dhe pajisjeve perberse të tij

Funksionet që duhet të kryejë sistemi konferencave

Sistemi duhet të jetë një sistem konferencash plug-and-play i pershtatshëm për takime të vogla apo të mesme, siç janë bashkitë.

Sistemi duhet të përbëhet nga:

- Njësia e Kontrollit'
- Aplikacioni i shfletuesit të internetit për shikimin dhe menaxhimin/konfigurimin e cilësimeve të sistemit.
- Njesite e Diskutimit, të disponueshme me një mikrofon të fiksuar me bisht të gjatë
- Njesia e Diskutimit duhet të jetë e konfigurueshme si një pajisje e anetareve ose si një pajisje e kryetarit
- Sistemi duhet të jetë i zgjerueshëm deri në 120 Njesi Diskutimi
- Komponentë ndihmës, siç janë: kapëse kabllorësh, kabllorë zgjatues, kapëse bllokuese kabllorësh
- Sistemi duhet të funksionojë me pajisje periferike opsionale që mund të lidhen, siç janë pajisjet amplifikatore audio dhe mikser, si edhe me kamera fikse HD apo HD PTZ
- Te kete ndërfaqe për aplikacione të palëve të treta nëpërmjet REST-API.

1. Njësia e Kontrollit

Njësia e Kontrollit duhet të jetë pajisja kryesore e sistemit.

- Njësia e Kontrollit duhet të përfshijë dhe opsionin regjistrim dixhital si edhe Shtypje të Feedback-ut Akustik Dixhital

Njësia e Kontrollit duhet të:

- furnizojë me energji DC të gjitha Pajisjet e Diskutimit të lidhura me sistemin, deri në 120 njesi.
- ofrojë një ndërfaqe për lidhjen e Pajisjeve të Diskutimit dhe pajisjeve periferike, siç mund të jete Njësia Zgjeruese.
- ofrojë një ndërfaqe për vendosjen e parametrave të sistemit, duke përfshirë një aplikacion shfletuesi interneti.
- ofrojë një ndërfaqe për regjistrimin audio të diskutimeve
- monitorojë dhe kontrollojë sistemin e diskutimit.

➤ **Njësia e Kontrollit dhe Karakteristikat teknike të saj**

Njësia e Kontrollit duhet të ketë karakteristikat dhe përfitimet e mëposhtme:

- Funkcionalitet plug-and-play për lidhje të shpejtë dhe të lehtë të Pajisjeve të Diskutimit.
- Butona intuitivë me prekje në panelin e përparmë për qëllime konfigurimi dhe funksionimi të lehtë.
- Tregues intuitivë LED për reagime të qarta dhe të menjëhershme mbi cilësimet e sistemit.
- Kontroll i shfletuesit të internetit – duhet të jetë e mundur të përdoret një aplikacion shfletuesi interneti për të parë dhe menaxhuar cilësimet e sistemit.
- Furnizim me energji (i zgjerueshëm) për 120 Pajisje Diskutimi.
- Kontroll i sistemit deri në 120 Pajisje Diskutimi.
- Aktivizim i njëkohshëm i altoparlantit dhe mikrofonit për të mundësuar ndjesinë e takimit ballë për ballë.

- Modaliteti i ndërprerjes për të aktivizuar Pajisjen e Diskutimit pavarësisht nga numri i mikrofonave të hapur.
- Modaliteti i gatishmërisë për të vendosur Pajisjet e Diskutimit në gatishmëri, p.sh. gjatë pushimeve, dhe për qëllime kursimi të energjisë.
- Mundësi për të fikur automatikisht CU-në dhe pajisjet e lidhura, pas 2 orësh mosaktiviteti, për qëllime kursimi të energjisë.
- Ndërrim i menjëhershëm i Pajisjeve të Diskutimit, pa pasur nevojë të fikni sistemin.
- Ndërfaqësoni ose ndërtoni aplikacione të personalizuar për kontrollin në distancë të sistemit nëpërmjet REST-API.

➤ **Njesia e kontrollit duhet të ketë butonat e mëposhtëm kapacitivë me prekje dhe treguesit LED:**

- Buton ndezjeje/fikjeje 24 VDC me tregues LED të kuq/jeshil.
- Butona plus/minus dhe tregues LED të gjelbër për vendosjen e diapazonit të volumit të të gjitha Pajisjeve të Diskutimit të lidhura.
- Buton për zgjedhjen e modalitetit të mikrofonit dhe tregues LED të gjelbër për zgjedhjen e njërit prej mënyrave të mëposhtme të funksionimit të mikrofonit: 'modaliteti i hapur', 'modaliteti i mbivendosjes', 'modaliteti i aktivizimit me zë' dhe 'modaliteti shtyp për të folur (PTT)'.
- Buton Numri i Mikrofonave të Hapur (NOM) dhe tregues LED të gjelbër për zgjedhjen e numrit të mikrofonave që mund të aktivizohen në të njëjtën kohë. Duhet të jetë e mundur të zgjidhni deri në katër mikrofonë të hapur në Njësinë e Kontrollit.

➤ **Njësia e Kontrollit duhet të ketë lidhjet e mëposhtme në pjesën e pasme të njësies:**

- 1 x lidhës rrethor femëror 4-polësh për hyrjen e energjisë 24 VDC.
- 2 lidhës rrethorë femërorë me 6 pole për lidhje me lak të 120 Pajisjeve të Diskutimit.
- 1 x lidhës Ethernet RJ45 për komunikim me aplikacionin e shfletuesit të internetit.
- 1 x lidhës hyrës mikrofoni femëror XLR 3-polësh me furnizim fantom.
- Hyrje RCA për 'Floor' (domethënë burim audio i jashtëm, si një CD ose DVD player).
- Dalje RCA për një 'sistem përforcimi zëri'.
- Hyrje/dalje RCA për njërën nga këto:
 - “Recorder” për lidhjen e një regjistruesi të jashtëm.
 - “Insertion” për lidhjen e një procesori audio të jashtëm.
 - “Telephone/mix minus” për t’i lejuar një pjesëmarrësi në distancë të bashkohet me një diskutim nëpërmjet një lidhjeje telefonike/video.
 - “Altoparlant pjesëmarrësi” për shpërndarjen e sinjalit të altoparlantit të pjesëmarrësit në një sistem përforcimi zëri.

➤ **Modalitetet e funksionimit të mikrofonit**

Katër modalitetet e mëposhtme duhet të jenë të zgjidhshme duke shtypur butonin e modalitetit të mikrofonit në panelin e përparmë të CU-së.

Në të gjitha modalitetet duhet të jetë e mundur të kufizohet Numri maksimal i Mikrofonave të Hapur (NOM). Të paktën katër mikrofonë duhet të jenë të zgjidhshëm në CU. Nëse përdoret aplikacioni i shfletuesit të internetit, duhet të jetë e mundur të zgjidhet një maksimum prej dhjetë mikrofonash.

- Modaliteti i hapur – duhet t'u lejojë pjesëmarrësve të bashkohen në diskutim duke shtypur butonat e mikrofonit të tyre. Kur të arrihet numri maksimal i mikrofonave të hapur, pjesëmarrësi tjetër që shtyp butonin e mikrofonit të tij duhet të shtohet në një 'listë pritjeje'. Pjesëmarrësi i parë në 'listën e pritjes' duhet të lejohet të flasë kur një mikrofon i aktivizuar është i çaktivizuar.
- Modaliteti i mbivendosjes – duhet t'u lejojë pjesëmarrësve të mbivendosen njëri-tjetrin duke shtypur butonat e mikrofonit të tyre. Kur të arrihet numri maksimal i mikrofonave të hapur, pjesëmarrësi tjetër që shtyp butonin e mikrofonit të tij duhet të çaktivizojë mikrofonin që është aktivizuar për kohën më të gjatë (mikrofoni i kryetarit nuk duhet të përfshihet në numrin e mikrofonave të hapur dhe, për këtë arsye, nuk mund të mbivendoset nga një pjesëmarrës).
- Modaliteti i aktivizimit me zë – duhet t'u lejojë pjesëmarrësve të aktivizojnë mikrofonat e tyre duke folur në to. Duhet të jetë e mundur të heshtni përkohësisht një mikrofon duke shtypur dhe mbajtur shtypur butonin e mikrofonit.
- Modaliteti Shtyp për të folur (PTT) – duhet t'u lejojë pjesëmarrësve të flasin duke shtypur dhe mbajtur shtypur butonat e mikrofonit. Një mikrofon duhet të çaktivizohet kur lirohet butoni i mikrofonit. Numri maksimal i pjesëmarrësve që mund të flasin duhet të përcaktohet nga numri i mikrofonave të hapur.

➤ **Specifikimet Teknike te njesise se kontrollit**

'Njësia e Kontrollit' duhet të ketë Specifikimet Teknike të mëposhtme:

- Elektrike
 - Tensioni i rrjetit 100 deri në 240 VAC $\pm$ 10%
 - Konsumi i rrymës Maksimumi 0.6 A (100 VAC) deri në 0.2 A (240 VAC)
 - Furnizim DC për Pajisjet e Diskutimit 24 V $\pm$ 1 V (rryma e kufizuar)
 - Numri i Pajisjeve të Diskutimit për Njësi Kontrolli Maks. 40 pajisje për lidhës kryesor
 - Kontrolli i volumit të altoparlantëve të Pajisjes së Diskutimit 15 hapa prej 1.5 dB (duke filluar nga -10.5 dB)
 - Niveli i pragut limit në njësi 12 dB mbi nivelin nominal
 - Reduktimi i fitimit për shkak të numrit të mikrofonave të hapur (NOM) $1/\text{SQRT}$ (NOM)
 - Shkalla e mostrës 44.1 kHz
 - Harmonika totale
 - Hyrja nominale (85 db SPL) $< 0.5\%$
 - Hyrja maksimale (110 db SPL) $< 0.5\%$
- Hyrjet audio
 - Mikrofon nominal XLR. Hyrja -56 dBV

-
- Hyrja maksimale e mikrofonit XLR -26 dBV
 - Hyrja nominale RCA -24 dBV (+/- 6 dB)
 - Hyrja maksimale RCA +6 dBV
 - S/N > 93 dBA
 - Përgjigje frekuençe 30 Hz deri në 20 kHz

➤ Daljet audio

- Dalja nominale RCA -24 dBV (+/- 24 dB)
- Dalja maksimale RCA +6 dBV
- S/N > 93 dBA
- Përgjigje e frekuencës 30 Hz deri në 20 kHz

➤ Mekanike

- Dimensionet (L x G x Th) 45 x 440 x 200 mm
- 19" e gjerë, 1 RU e lartë
- Montimi Sipërfaqe tavoline
- Raft 19 inç

➤ Mjedisi

- Temperatura e funksionimit 5 °C deri në +45 °C
- Temperatura e ruajtjes -40 °C deri në +70 °C
- Lagështia relative 5% deri në 98% pa kondensim

➤ Rregjistrimi audio dhe Shtypje të Feedback-ut Akustik Dixhital

- Regjistruar dixhital i integruar me memorie të brendshme dhe regjistrim USB.
- Prizë e integruar për altoparlant dhe kufje për të dëgjuar diskutimet e regjistruara përpara se t'i riluani ato në sallë, ose të dëgjoni regjistrimet.
- Butona shtesë me prekje kapacitive dhe tregues LED për:
 - Volumn e altoparlantit CU (ose volumn e kufjeve, nëse janë të lidhura).
 - Nisjen, Puzën (mbajtjen) dhe Ndalimin e regjistrimit.
- Shtypjen e Feedback-ut Dixhital Akustik të integruar (DAFS).
- Lidhës USB në pjesën e përparme të njësisë për lidhjen e një memorijeje USB.
- Prizë për kufje stereo 3.5 mm (0.14 in).
- Lidhës mikro USB në pjesën e pasme të njësisë për transferimin e memories së brendshme (regjistrimet) në një PC.
- Katër dalje shtesë RCA për regjistrim individual të mikrofonit, p.sh. për regjistrimin e folësve individualë në një sallë konference.

➤ Regjistruar dixhital i integruar

Regjistruesi i integruar duhet të mundësojë regjistrimin e diskutimeve në formatin MP3 në memorien e brendshme ose në një USB memory stick me të paktën një kapacitet prej 128 GB:

- Regjistrimet në memorien e brendshme duhet të ruhen automatikisht në memorien e brendshme, përveç nëse një USB memory stick është i lidhur me lidhësin USB në pjesën e përparme të CU-së. Memoria e brendshme duhet të jetë në gjendje të regjistrojë deri në 8 orë diskutim.
- USB memory stick – regjistrimet duhet të ruhen automatikisht në një USB memory stick kur ai është i lidhur me CU-në. Një USB memory stick prej 128 GB duhet të jetë në gjendje të regjistrojë deri në 4,000 orë diskutim.

Regjistrimet mund të ruhen në orë ose mund të ruhen opsionalisht për të gjithë kohëzgjatjen e takimit.

Treguesit LED duhet të informojnë përdoruesit kur të dhënat po regjistrohen në memorien e brendshme ose në një USB memory stick. Treguesi LED i përshtatshëm duhet të zgjidhet automatikisht kur një USB memory stick futet ose hiqet nga lidhësi USB.

Tre sinjale BIP të shkurtra dhe një LED me pulsime të kuq duhet të tregojnë kur kanë mbetur 5 minuta regjistrim. Një BIP i gjatë dhe një LED me pulsime të kuq/jeshil do të tregojnë kur nuk është e mundur të regjistrohet një diskutim (p.sh.: memoria e brendshme është plot dhe USB memory stick nuk është i lidhur me CU-në, USB memory stick është plot ose i dëmtuar).

➤ Specifikimet Teknike

"Njësia e Kontrollit me regjistrim dhe Shtypje të Feedback-ut Akustik Dixhital "DAFS" duhet të ketë të njëjtat specifikime teknike si "Njësia e Kontrollit", si dhe specifikimet teknike të mëposhtme:

Regjistrues

Regjistrim/Luajtje

(shpejtësia e bitit) 64, 96, 128, 256 Kbit/sek

Regjistrim/Luajtje (frekuenca e mostrës) 44.1 kHz

Altoparlant monitorues

Dalja nominale 72 dB SPL

Përgjigja e frekuencës 200 Hz deri në 12.5 kHz

Diapazoni i përforcimit, heshtja -10.5 deri në +12

Përputhshmëria me kartën e memories USB

Kartë memorieje USB SanDisk e formatuar me sistemin e skedarëve FAT32.

Madhësia maksimale: 128 GB

➤ *Kapaciteti i regjistrimit në orë*

Orët e memories së brendshme Orët e kartës së memories USB/16 GB 32 GB 64 GB 128 GB

64_8 orë 500 1000 2000 4000

96_5 orë 350 700 1400 2800

128_4 orë 250 500 1000 2000

Set Montimi në Raft 19-inç

Ky set duhet të përbëhet nga kllapa dhe elementë të tjerë të nevojshëm fiksues për të mundësuar montimin e njesise se kontrollit në një sistem RAK 19-inç.

➤ *Aplikacioni i shfletuesit të internetit*

Duhet të jetë e mundur të përdoret një aplikacion shfletuesi interneti i instaluar në një tablet, laptop ose PC për të parë dhe menaxhuar/konfiguruar cilësimet e sistemit, siç janë cilësimet e kamerës, menaxhimi i mikrofonit dhe opsionet e regjistrimit dixhital.

Aplikacioni i shfletuesit të internetit duhet të jetë i zbatueshëm për përdorim me shfletuesit e mëposhtëm më të përdorur, përkatësisht:

- **Google Chrome**
- **Mozilla Firefox**
- **Internet Explorer**
- **Safari**
- **Opera**

Për të parandaluar aksesin e paautorizuar në cilësimet e sistemit, përdoruesit duhet të kenë të drejta të veçanta hyrjeje. Përdorues të shumtë mund të hyjnë në shfletuesin e internetit në të njëjtën kohë.

Ndryshimet e konfigurimit të bëra në aplikacionin e shfletuesit të internetit duhet të përditësohen automatikisht në shfletuesin e internetit. Po kështu, ndryshimet e konfigurimit të bëra në njesine e kontrollit duhet të përditësohen në aplikacionin e shfletuesit të internetit.

Të gjitha cilësimet e ruajtura saktë duhet të jenë ende të disponueshme pas një fikjeje të kontrolluar ose të papritur të sistemit. Nëse ndodh një fikje e papritur e sistemit gjatë regjistrimit, regjistrimi duhet të jetë ende i disponueshëm kur energjia elektrike të rilidhet në sistem.

2. Pajisje mikrofon per delegatet

Pajisja e Diskutimit duhet t'u mundësojë pjesëmarrësve të marrin pjesë në një diskutim duke folur në mikrofon dhe duke dëgjuar diskutimet në një altoparlant. Pajisja duhet të ketë karakteristikat dhe përfitimet e mëposhtme:

- Funksionalitet plug-and-play.
- Me tregues LED në Pajisjen e Diskutimit dhe në kokën e mikrofonit.
- Zgjedhje e mikrofonit të shkurtër ose të gjatë fiks me këmbë fleksibile.
- Me altoparlant te integruar në pjesën e përparme të pajisjes.
- Prizë e integruar për kufje me kontroll të nivelit të daljes.
- Ulje automatike e nivelit kur aktivizohet mikrofonit (i konfigurueshëm nëpërmjet aplikacionit të shfletuesit të internetit të Njesisë së Kontrollit): parandalon reagimin akustik nga kufjet në mikrofon.
- I konfigurueshëm si pajisje e pjesëmarrësit ose kryetarit: butona të ndryshueshëm të mikrofonit dhe çelës rrëshqitës i fshehur në pjesën e poshtme të pajisjes për qëllime konfigurimi.
- I pandjeshem ndaj frekuencave ndaj GSM.

➤ Pajisja duhet të ketë kontrollet dhe treguesit e mëposhtëm të përdoruesit:

- Buton mikrofonit.
- Tregues LED i koduar me ngjyra mbi butonin e mikrofonit për të treguar statusin e pajisjes, gati për të folur ose mbyllur
- Kur LED vezullon tregon që pjesëmarrësi është i pari në listën e pritjes, d.m.th. i radhës në radhë për të folur.
- Në ngjyre të kuqe tregon që mikrofonit është aktiv.
- Tregues unaze me dritë të koduar me ngjyra në kokën e mikrofonit: E gjelbra tregon që një kërkesë për të folur është shtuar në listën e pritjes; vezullimi i gjelbër tregon që pjesëmarrësi është i pari në listën e pritjes; E kuqe tregon që mikrofonit është aktiv.
- Kontroll rotative me gishta në anën e pajisjes për rregullimin e volumit kur përdoren kufje për perkthim.
- Buton i fshehur inicializimi në bazën e pajisjes për ricaktimin e adresës së rrjetit.
- Çelës rrëshqitës i fshehur në bazën e Pajisjes së Diskutimit për konfigurimin e pajisjes si një pajisje pjesëmarrësi ose pajisje e kryetarit. Për të parandaluar funksionimin aksidental, duhet të jetë e mundur të konfigurohet çelësi vetëm me një mjet, p.sh. kapëse letre të përkulur.
- Konfigurimi për funksionin e kryetarit - buton i veçantë i mikrofonit dhe buton i përparësisë.
- Pajisja e kryetarit duhet t'i mundësojë përdoruesit të funksionojë si kryetar në një konferencë ose takim.
- Mikrofonit i kryetarit duhet të aktivizohet kur shtypet dhe mbahet shtypur butoni i përparësisë.
- Të gjithë mikrofonat e pjesëmarrësve aktualisht aktivë duhet të jenë të heshtur, duke i lejuar kryetarit të marrë kontrollin e takimit.

-
- Do të ndjehet një tingull akustik për të njoftuar se kryetari është gati të flasë.
 - Pajisja duhet të ketë lidhjet e mëposhtme:
 - 1 x lidhës femëror rrethor 6-polësh në pjesën e pasme të pajisjes me zgavër mbyllëse kabllor
 - 1 x prizë kufjesh stereo 3.5 mm (0.14 in) në anën e pajisjes
 - 1 x kabllor 2 m (78.7 in) me një lidhës mashkullor rrethor 6-polësh me kyç kabllor

Pas lidhjes së Pajisjes së Diskutimit me sistemin për herë të parë, duhet të jetë e mundur të inicializohet pajisja duke shtypur butonin e mikrofonit ose butonin e inicializimit në pjesën e poshtme të pajisjes.

Specifikimet Teknike të mikrofonit të delegative dhe kryetarit

"keto mikrofona" duhet të kenë Specifikimet Teknike të mëposhtme:

➤ Elektrike

- Përgjigje frekuence 200 Hz deri në 12.5 kHz
- Impedanca e ngarkesës së kufjeve > 32 ohm < 1k ohm
- Dalja nominale e altoparlantit 72 dB SPL

➤ Mekanike

- Dimensionet e pajisjes pa mikrofon
- (L x Gj x Th) 64 x 203 x 146 mm
- Lartësia me mikrofon në pozicion horizontal 130 mm

➤ Qendrueshmëria në ambient

- Temperatura e funksionimit 0 °C deri në +35 °C
- Temperatura e ruajtjes -40 °C deri në +70 °C
- Lagështia relative 15% deri në 90%

3. Kabllor Zgjatimi

Kabllot Zgjatuese duhet të kenë një mbështjellës gri PVC me diametër 6 mm (0.24 in) dhe duhet të jenë të njëjta ose të ngjashme me:

- Kabllor Zgjatimi 2 m i përfunduar me lidhëse.
- Kabllor Zgjatimi 5 m i përfunduar me lidhëse.
- Kabllor Zgjatimi 15 m i përfunduar me lidhëse.
- Kabllor Zgjatimi 20 m i përfunduar me lidhëse.

4. Kontroll automatik me kamera për sistemin konferencë

➤ Sistemi duhet të jetë në gjendje të mbështesë komunikimin natyral me të paktën deri në gjashtë kamera dhe një celes automatik videoje për të treguar folësin aktiv.

- Protokollet e mëposhtme të kamerave duhet të mbështeten:
- Kontrolli i kamerave të pajtueshme me Onvif Profile-S me emër përdoruesi dhe fjalëkalim.

- Mbështetja e kamerave Panasonic nëpërmjet protokollit të saj IP: AW-HE40, AW-HE50, AW-HE60, AW-HE120, AW-HE130, AW-UE70, AW-UE150
- Mbështetja e kamerave Sony nëpërmjet protokollit të saj IP: SRG-300SE, SRG 360SHE, BRC-X400

Funksioni i sistemit conference me kamera do të mbështetet nga modulet:

- TvOne CORIOmatrix
- KramerMV-6 video

Aplikacioni i shfletuesit të internetit duhet të përdoret për të:

- zbuluar dhe zgjedhur kamerat e lidhura të sistemit.
- përcaktuar pozicionet paraprake të kamerave.

5. Mikser me amplifikator

Një amplifikator mikseri 240 W duhet për t'iu përshtatur kërkesave të instalimeve të altoparlanteve për një performance të lartë të sistemit conference.

Ky amplifikator mikser ka karakteristika të nevojshme si më poshtë:

Hyrje të gjithanshme: 4 hyrje, 2 opsione mikrofoni/linje me mbështetje për energji fantom

Dalje me fuqi të plotë që mbështet hyrje mbivendosjeje EMG 4Ω, 8Ω, 70 V dhe 100 V, duke siguruar që mesazhet kritike të dëgjohen qartë

Mbivendosje kontakti me sinjal 2-tonëshe për alarme që tërheqin vëmendjen

Filtra me kalim të lartë 70 Hz dhe 120 Hz për të personalizuar daljen audio dhe për të eliminuar zhurmën e padëshiruar me frekuencë të ulët

Dizajn kompakt ½ rack që kursen hapësirë, duke ofruar lehtësi pa kompromentuar performancën VOX Ducking që rregullon automatikisht volumnin e muzikës në sfond për komunikim të qartë me zë

Aktivizim në distancë i modalitetit të gatishmërisë me Remote OFF (Në pritje), duke rritur efikasitetin e energjisë

Specifikime teknike të mikser amplifikatorit

Mains power supply

U240:1M

Voltage 100 VAC - 240 VAC $\pm 10\%$, 50/60 Hz

Power consumption

- Standby (Remote OFF active) 1.25 W
- Idle mode LoZ amp Mode ($4\ \Omega$ / $8\ \Omega$) 10 W / 12 W

Mains power supply

- Idle mode HiZ amp mode (70 V / 100 V) 10 W / 14 W
- 1/8 rated Output power 55 W Remote power (ON/OFF Stand by) 2-pin, Eurostyle, contact closure

Performance

Frequency response, -3 dB ref. 1 kHz

- Any input to output <20 Hz — 20 kHz
- EMG input to output <20 Hz — 15 kHz
- Any input to LINE output <10 Hz — 60 kHz

Distortion <0.5% @rated output power, 1 kHz

Output stage topology Class D

Equalization

- Bass shelving ± 12 dB / 100 Hz
- Treble shelving ± 12 dB / 10 kHz

Filter

- LO-CUT permanently $f=20$ Hz, 12 dB/oct.
- HI-PASS (HPF) switchable, can be activated $f=120$ Hz, 12 dB/oct.

General

Front status LEDs

- Protect (Red) Protection
- Peak (Red) 1 dB before clip (input and output)
- Signal (Green) Input and output signal

- Call (Green) EMG / priority trigger / Vox input active
- Power (Green) Power on condition DIP switches EMG (HiZ/Line level), Two-tone Chime (ON/OFF), HPF (120 Hz), VOX (ON/OFF), Phantom power (+48 V/OFF) Output (HiZ/LoZ), Amp mode (70 V/100 V; 4Ω/8Ω)

Protections

- Amplifier Audio limiters, high temperature, DC, HF, short circuit, over current protection
- Switching mode power supply Mains over/under voltage protection, inrush current limiter, mains over current, high temperature
- Remote power OFF Contact closure

6. Altoparlante

Altoparlant woofer për performancë të zgjatur të LF deri në 55 Hz

- Trajtimi i fuqisë 75 W siguron 108 dB
- SPL maksimale (Pika 114 dB)
- Transformator 60 W me kalim 8 Ω
- EN 54-24 dhe UL1480
 - Specifikimet teknike
- Përgjigje frekuence (-3 dB): 90 Hz - 20 kHz1 & Përgjigje frekuence (-10 dB) 55 Hz - 20 kHz1
- Ndjeshmëria: 89 dB2 SPL Maks (e llogaritur): 108 dB, 114 dB Kulmi
- Këndi i mbulimit: Horizontal 90°, Vertikal 90°
- Trajtimi i fuqisë: 75 W (Kulmi 300 W) Rozë e vazhdueshme
- Impedanca nominale: 8 Ω
- Impedanca minimale: 6.5 Ω
- Kalimi i lartë i rekomanduar: 60 Hz (24 dB/oktavë)
- Transformatori 1: 70V/ 60 W, 30 W, 15 W, 8 W, 8Ω
- Transformatori 2: 100V/ 60 W, 30 W, 15 W, 8Ω
- Transduktor me frekuencë të ulët: (133 mm)
- Transduktor me frekuencë të lartë: (20 mm)
- Altoparlantet duhet të jenë rezistent ndaj kushteve të motit sipas IEC 60068-2-5 agjenteve të Kripës, IEC 60068-2-42 SO2, IEC 60068-2-60 Klorit, kushteve të testimit IEC 60529 IP65
- Certifikuar EN54-24

7. Mikrofone levizes pa kabell

Sistemi mikrofonik pa tel UHF.

Me frekuenca 2 x 4 kanale për fleksibilitet është projektuar duke pasur parasysh thjeshtësinë dhe lehtësinë e përdorimit. I pajisur me një çantë praktike mbajtëse, komplet montimi në raft dhe antena të shkëputshme, që të ofrojë një performancë të saktë dhe të besueshme.

Plani i frekuencave të këtij sistemi të jete i ndarë në dy grupe me 4 kanale të disponueshme në secilin grup, të ndarë midis gamës së frekuencave pa licencë në të gjithë Evropën dhe boshllëkut dupleks LTE. Përdoruesi të mund të zgjedhi deri në 4 kanale nga 1 grup.

Sistemi të jete lehtësisht i përdorshëm në raste dialogesh apo prezantime për auditorë akademikë apo konferenca.

- Specifikimet teknike:
 - Diapazoni i Frekuencës 824 - 831 MHz, 863-865 MHz Modaliteti i Modulimit FM
 - Numri i Frekuencave 2x 4-frekuenca, Frekuenca të Njëkohshme 4
 - Devijimi Maksimal +/- 33 kHz
 - Temperatura e punës: +5°C - +45° C
 - Reagimi i Frekuencës: 60 Hz - 16 kHz
 - Stabiliteti i Frekuencës +/- 0.005%, Kontrolli i frekuencës së lakut të bllokimit të fazes
 - Sistemi i Marrjes: Diversiteti i Ndërrimit të Antenës
 - Diapazoni Dinamik: HH: 108 dB, BP 103 dB (@ devijimi maksimal)
 - Ndjeshmëria: 10dBμV (S/N 60dB @ devijimi 20 kHz)
 - Totali Shtrembërimi Harmonik: <1% - devijim 20 kHz @ 1 kHz
 - Kontrolli i Nivelit: Mikrofon / Linjë (0 / -20dB)
 - Hyrja e Antenës: Lloji BNC, 50 - tension BIAS 12V DC 100mA secila
 - Dalja Audio: E pabalancuar -2dBV, E balancuar 4dBV
 - Lidhësit e Daljes: Të pabalancuar: 6.3 mm mono jack E balancuar: Lloji XLRM
 - Niveli i Fshihjes: 2 μV (min) ~ 60 μV (maks)
 - Zgjedhja e Kanalit: Ekran LED me 7 segmente me 2 shifra
 - Furnizim me Energji: 100-240 V DC12V 500mA
- TRANSMETUES BODY-PACK ME MIKROFON QE VENDOSËT NË JAKEN E XHAKETES
 - Fuqia dalëse RF: 10 mW
 - Lidhjet hyrëse: Pin 1: GND, Pin 2: INST, Pin 3: Mik, Pin 4: DC Bias +10V
 - Bateritë (nuk përfshihen): Dy alkaline 1.5V AA
 - Jetagjatësia e baterisë: 10 orë - në varësi të llojit të baterisë dhe modelit të përdorimit
- TRANSMETUES DORË ATW-T3
 - Fuqia dalëse RF: 10 Mw
 - Lidhjet hyrëse: Pin 1: GND, Pin 2: INST, Pin 3: Mik, Pin 4: DC Bias +10V

- Bateritë (nuk përfshihen): Dy alkaline 1.5V AA

Jetagjatësia e baterisë: 10 orë - në varësi të llojit të baterisë dhe modelit të përdorimit

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Mikrofona

Nr	Përshkrimi	Sasia	Afati I Levrim
1	FV. Njësia e delegatëve – mikrofon tavoline digjital	19	10 dite
2	FV. Njësia e kryetarit– mikrofon tavoline me prioritet	1	10 dite
3	FV. Njësia qendrore e kontrollit për sistem konference digjitale	1	10 dite
4	FV. Altoparlantë mural, min 60W / sistem 100V	4	10 dite
5	FV. Amplifikatori audio profesional, sistem 100V, min. 250W	1	10 dite
6	FV. Mikrofon wireless set marres+mikrofon dore	2	10 dite
7	FV. Rack metalik për pajisje, 600 × 600 mm, 22U	1	10 dite
8	FV. Kabëlli zgjatues me konektor 6 pole, mashkull-femer, 20m	2	10 dite
9	FV. Kabëlli zgjatues me konektor 6 pole, mashkull-femer, 5m	6	10 dite
10	FV. Kanaline plastike për kabllim, 40 × 25 mm, ml	65	10 dite
11	FV. Kabell audio per lidhjen e bokseve 2x1.5mm	75	10 dite

Afatet e lëvrimit: 10 (dhjete) ditë nga nënshkrimi i kontratës

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfasuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

2% te fondit limit i cili është 1,833,236 leke pa TVSH

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 30 % e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe / ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën **ISO 9001:2015 “Mbi Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë” / ose ekuivalent** (të vlefshme në datën e zhvillimit të tenderit), në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një **deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër **montimin**.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një **deklaratë** garancie ku të deklarojë se artikujt e ofruar do të kenë jo më pak se 1 (një) vit garanci nga data e furnizimit të mallit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim. **Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 9.*(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)***FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
 _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

